



OPŠTINA BUJANOVAC
KOMUNA E BUJANOCIT
MUNICIPALITY OF BUJANOVAC

Rr.K. Petroviq, nr.115, Bujanoc
Tel: 017/654-517; Fax: 017 654-517; www.bujanovac.rs

Komisioni për ndarjen e subvencioneve për biznese dhe bujqësi, nga donacion i Qeverisë së Kosovës, shpall:

KONKURS

Ftohen bizneset lokale nga territori i Komunës së Bujanocit, veprimtaria e të cilëve ka qenë e ndaluar së funksionuari gjatë gjendjes së jashtëzakonshme të shpallur nga Qeveria e Serbisë për luftimin e koronavirusit, që të aplikojnë për mjetet e destinuar si ndihmë për bizneset nga fondi COVID i Komunës së Bujanocit.

Të drejtë aplikimi në këtë konkurs, kanë vetëm ato biznese, që me vendim të Qeverisë së Serbisë, e kanë pasur të ndaluar ushtrimin e aktiviteteve biznesore – kanë qenë të mbyllura.

Dokumentacioni:

- Formulari i plotësuar në formë elektronike (kompjuter),
- Vendimi nga Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve (APR)
- Deklarata e lirë e ndërmarrësit/sipërmarrësit që gjatë kohës së gjendjes së jashtëzakonshme nuk ka larguar asnjë punëtor nga puna

Afatet: Konkursi do të jetë i hapur nga 28.05.2020 deri më 04.06.2020 ora 15:00h.

Shuma e mjeteve totale për këtë konkurs është 5.4 milionë dinarë.

Të gjitha aplikacionet dorëzohen përmes shkrimores së Administratës komunale (Kati i parë), ose edhe përmes postës së përgjithshme në adresën; Komuna e Bujanocit, rruga Karagjorgje Petroviq, numër 115, për: "Konkursin e subvencionimit të bizneseve lokale nga Fondi COVID i Komunës së Bujanocit."

Në Bujanoc, më 28.05.2020

ADMINISTRATA KOMUNALE E BUJANOCIT

Kryetar i Komisionit

Rahim Salihi

